

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.514/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri në çështjen penale kundër të pandehurit F.V. nga ... “...” për shkak të veprës penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjat kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP-II-.nr.1485/2016 të datës 24.06.2016, në seancën e mbajtur me dt.30.04.2019, në mungesë të prokurorit e në prezencën të të pandehurit F.V. në të njëjtën datë ka shpallur publikisht, ndërsa me 02.05.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: F.V., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me ..., në ... ku edhe tani jeton në “...”, me nr. Personal ..., ka qene në paraburgim nga dt. 28.05.2016 gjer me datën 10.06.2016 e nga kjo datë është nën masën e arrestit shtëpiak gjere me datën 27.06.2016, i martuar ka të kryer shkollën fillore , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:Me dt.28.05.2016 rreth orës 15:45 min. në rrugën “...” në ... afër lokalit “...” deri sa Njesia Patrolluese BC-401 ishin në detyrë të caktuar nga baza lidhur me një parkim të pa rregull-policet të dëmtuarit - B.K. dhe A.B. dhe deri sa ata bisedonin me ankuesin afër veturës së dyshuar audi “prone e të pandehurit” F.V. i cili shkon pran policve dhe u tregon policve që është vetura e tijë por kur policet i kërkojnë dokumentet e veturës ai jo që nuk u a prezanton por i njëjti i kanos me fjalët “Kush jeni me jav dhene dokumentet juve, ka me jav q... nonen edhe ropt, shkoni në p... të nonës së ju ma skeni me jetu” fjale këto nënkuptojnë që ai refuzonte të jepte dokumentet dhe kur zyrtari policor A.B. e ka pyetur se “qka janë ato” duke aluduar në dokumentet që vëreheshin në xhepin e xhakëtës ai menjëherë ja kthen me fjalët “kam allti, edhe bume” ashtu që duke sharë e fyer zyrtaret policor merr pozitën sulmuese duke i ngritur duart lart dhe duke i bere grushta u drejtohet me fjalët “Tash e shihni kush jam une” dhe ashtu me gjeste dhe duart me grusht të ngritura sulmi drejtohet nga zyrtaret policor që ti sulmoj ,atëherë policet e bindur se personi i dyshuar don ti sulmoj marrin veprime mbrojtse ku polici B.K. e ka terhekur sprejin OC dhe i ka hedhur syve ndërsa polici A.B. nga mbrapa ka provuar që t’ia vendos prangat dhe të njëjtin ka vendosur nën kontroll mirëpo i pandehuri edhe në këtë rast ka refuzuar që të prangoset dhe ka shtyrë policin A. i cili është rrezuar për tokë dhe si pasojë e këtij rrëzimi ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta në regjionin e parakrahut të majte, me pasoja të përkohshme në shëndet dhe derisa e kanë vendosë në automjetin e policisë i pandehuri në shenje rezidence e ka goditur policin - të dëmtuarin B.K. shqelm në këmben e djathtë nëngju, Me këtë ka kryer veprën penale - **Sulmi ndaj personit zyrtar gjate kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-se.**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 4,7,8,9,10,21,41,43,45,73, dhe 410 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 të KPP-ës i:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar ne paraburgim qe nga data 28.05.2016 gjer me datën 10.06.2016 e nga kjo date nën masën e arrestit shtëpiak gjer me datën 27.06.2016, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore shumen prej 20 euro dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil .

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP.nr.1485 /2016 te datës 24.06.2019, kundër te pandehurve F.V. dhe N.B., për shkak te veprës penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410 par .2 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin me dt.30.04.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri F.V. e ka pranuar fajësinë për veprën penale qe ngarkohet sipas aktakuzës, dhe i premton gjykatës se nuk do te përsërisë veprën penale te tille apo te ngjajshme, dhe njëherit i Vjen keqe për rastin qe ka ndodhur pasi qe janë edhe persona për te mbajtur rendin dhe sigurinë ne vende.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit F.V. prokurori shtetit deklaroi: e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i cili pranim mbështetet ne provat qe gjenden ne shkresat e lende, dhe se kundër te pandehurit gjykata te veproje sipas ligjit.

Mbrojtësi i te pandehurit av. F.V., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: pas konsultimeve te mjaftushme me klientin tim, duke i sqaruar pasojat dhe bënifitet e fajësisë, klienti im me vedije te plote e pranone fajësinë ndihet i penduar per veprën penale qe i ka ndodhur dhe i premtonte gjykatës se me asnjëherë nuk do te përsërisë vepra penale te tille apo tjetër penale, po ashtu e lute gjykatën qe gjate shqiptimit te dënimit te ketë parasysh se është mbajtes i familjes.

II. Vlerësimi i pranimin te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimin te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë

faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti policor 2016-BI-61 të datës 29.05.2016, raportet e oficerit të datës 28.05.2016 raportin informues hetimor të datës 28.05.2016, raportin mjekësor në emër të të dëmtuarit A.B. lëshuar nga spitali i përgjithshëm emergjenca Mitrovica të datës 28.05.2016, aktvendimi mbi ndalimin e personave të arrestuar të datës 28.05.2016, informacionet e personave-dosjet kriminale, ekspertiza mjeko-ligjore me nr.ref. 147-M të datës 03.06.2016 në emër të të dëmtuarve, si dhe vështrimi në foto dokumentacionet e hetimit. Nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-se.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me dënim me burgim prej 6 muajsh deri në 5 vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale, në rastin konkret murr faktin se kjo veprë penale është drejtuar kundër personit zyrtar që janë të thirrur për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë e një veprimi i tillë e humb imazhin e organit përgjegjës. po ashtu si rrethana rënduese gjykata murr faktin se i njëjti ishte i evidentuar edhe për shumë vepra të tjera penale andaj i njëjti konsiderohet si recidivist i veprave penale.

Si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë rezulton se ai edhe vet deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale.

Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton dënim i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykatë vlerëson e edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale-paushallin gjyqësor shumen prej 20€ ndërsa në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumen prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumen prej 30 euro, të gjitha këto është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

IV. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata të dëmtuarit i ka udhëzuar në konteste të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në neni 248, 365, 450, e 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.514/2016 dt.02.05.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari:
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.